



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 11, datë 08.11.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN: “ZGJERIM I RRJETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE TË OPERATORIT “TELEKOM ALBANIA”
NËPËRMJET SHTIMIT TË ANTENAVE PËR 3 STACIONE BAZË TË EMËRTUARA:
“AMC BUILDING 0184”, “JALA PLAZH 1621” DHE “SPILLE 1247”, ME
VENDNDODHJE NË BASHKITË TIRANË, HIMARË DHE KAVAJË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe VKM-së Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, e ndryshuar, me propozim të shoqërisë “Telekom Albania” sh.a, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Zgjerim i rrjetit të komunikimeve elektronike të operatorit “Telekom Albania” nëpërmjet shtimit të antenave për 3 stacione bazë të emërtuara: “Amc Building 0184”, “Jala plazh 1621” dhe “Spille 1247”, me vendndodhje në Bashkitë Tiranë, Himarë dhe Kavajë”, me zhvillues shoqërinë “Telekom Albania” sh.a.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejes së Ndërtimit i jepen subjektit zhvillues, veçmas, për secilin prej 3 stacioneve bazë, vetëm pas plotësimit të kushteve të poshtëshënuara:
 - a. Për stacionin “**Amc Building 0184**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Tiranë.
 - b. Për stacionin “**Jala plazh 1621**”:
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Himarë.
 - c. Për stacionin “**Spille 1247**”:
 - regjistrimit të Lejes së Legalizimit pranë Drejtorisë Vendore të ASHK Kavajë;
 - pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Kavajë.



4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI
EDI RAMA

MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

